



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Adresa "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë

E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr 62/150 Prot.

Tiranë, më **22.12.2018**

**VENDIM**

Nr 244, datë **22.12.2018**

**PËR**

**"DELEGIM KOMPETENCE"**

Bazuar në:

- nenin 162/2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton se "*Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit "qëndron në detyrë për 7 vjet, më të drejtë rizgjedhjeje"*";
- nenin 25, germa "ë", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", mbi kompetencën e Kryetarit "*për të përcaktuar strukturën, organikën dhe emërtimin e funksioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- nenin 23, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", që përcakton se "*Mandati i Kryetarit të KLSH-së mbaron kur: a) mbaron afati shtatëvjeçar i qëndrimit në detyrë*";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI të INTOSAI-t, Udhëzuesit e aplikueshëm dhe praktikat më të mira bashkëkohore që i kontribuojnë mbrojtjes së paanshmërisë, objektivitetit, neutralitetit politik dhe besueshmërisë së institucionit suprem të auditimit (ISSAI 30);
- Ligjin nr. 44/2015, datë 30.4.2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*";

- Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 27, datë 20.04.2018, “Për miratimin e Kodit Etik të Kryetarit dhe drejtuesve të lartë të KLSH”,
- Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 238, datë 21.12.2018, “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 4, datë 27.01.2017, “Për Strukturën e renditjes së punëve, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave në Kontrollin e Lartë të Shtetit”, i ndryshuar”,

### **VENDOSA:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit tek Zëvendës/Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.
2. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen nga Zëvendës/Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Drejtori i Përgjithshëm znj. Lindita Lati (Milo) nga data e botimit në fletoren zyrtare deri në paraqitjen në detyrë të Kryetarit të ri të KLSH-së.
3. Vendimi do përcillet në fletoren zyrtare, pasi Kryetari i KLSH-së të kontaktojë dhe të marrë mirëkuptimin e Presidentin të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryetarëve të Grupeve Parlamentare të Opozitës dhe Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.
4. Kryetari i KLSH-së i kërkon Kryetarit të Kuvendit që Konferenca e Kryetarëve të njihet me këtë vendim.
5. Vendimi përcillet në fletoren zyrtare në ditët e para të janarit dhe hyn në fuqi pas botimit në të.

**Bujar LESKAJ**

**KRYETAR**